



Skënderbeu është eliminuar nga Europa League pas gjuajtjes së penalltive. Për Josen, ne karrieren e tij si trajner, kjo ishte humbja e parë pas ekzekutimit të 11-metershave.

"Humbje e vështirë për tu kaluar, kur mundesh pas gjuajtjes së penalltive. Kjo ishte humbja ime e parë si trajner në një situatë të tillë.", u shpreh Mirel Josa pas përfundimit të ndeshjes Skenderbeu-Cernomoret.

"Ishte me të vertete vështirë të shikoja fytyrat e lojtarëve pas ndeshjes. Ata dhane maksimumin dhe unë i vlerësoj për këtë. Do të duhet të punoj për të ngritur moralin që të jenë gati për ndeshjen e hapjes së Kampionatit, sepse nga përgatitja fizike ata janë gati", theksoi Josa, i cili e dinte se skuadra e tij do të kishte shumë të vështirë ndaj një kundërshtari prestigjioz.

"Ne e filluam lojën shumë mirë dhe luajtëm ashtu siç duhej në pjesën e parë, mirë edhe me kujdes. Lojtarët e mij zhvilluan një ndeshje shumë të mirë dhe nuk patën fat tek penalltitë. Ata meritojnë lavderimet me të mira, nderkohe që i uroj Odeses suksese të mëtejshme dhe një aktivizim me të shpeshtë të Vangjelit dhe Bakajt me skuadrën Ukrainase", u shpreh Josa, i cili kishte si preferencë zhvillimin e takimit në Korçë.

"Sigurisht, doja që ndeshja të luhej në Korçë. Fushe fantastike, tifozeri të mrekullueshëm, por atmosfera edhe në Tiranë ishte e mirë dhe në dhame gjithçka për tifozat tanë sot", vazhdoi Josa i cili përfundoi duke theksuar:

Mirel Josa: Humbje e vështirë, nuk fajësoj asnjë nga lojtarët

nga AlbaniaSoccer

E premte, 30 Gusht 2013 06:30

"Tani vetem deshiroj te shkoj ne shtepi dhe te takoj familjen"